



---

**INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES  
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT  
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLANJA**

**QEVERIA E KOSOVËS - GOVERNMENT OF KOSOVO - VLADA KOSOVA**

**MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE  
MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE  
MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZAŠTITE**

---

Në përputhje me nenin 1 pika 1.3 paragrafi (b) të Rregullores 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë.

Duke pasur parasysh neni 14 të Ligjit për Statusin dhe të Drejtat e Familjeve të Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve dhe Pjesëtarëve të UÇK-së dhe Familjeve të Viktimave Civile të Luftës

Me qëllim të aplikimit sa më të drejtë dhe efikas të Ligjit, Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale nxjerr këtë:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV  
NR 09 / 2006**

**për**

**PROCEDURAT E APLIKIMIT NË SKEMËN E PENSIONEVE DHE BENEFICIONEVE TË  
PËRCAKTUARA ME LIGJIN PËR STATUSIN DHE TË DREJTAT E FAMILJEVE TË  
DËSHMORËVE, INVALIDËVE, DHE PJESËTARËVE TË UÇK-SË DHE FAMILJEVE TË  
VIKTIMAVE CIVILE TË LUFTËS**

## **Neni 1**

### **Qëllimi**

Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim rregullimin dhe përcaktimin e procedurave administrative të aplikimit për përfitimin e pensioneve dhe beneficioneve, të përcaktuara me Ligjin për statusin dhe të drejtat e familjeve të Dëshmorëve, invalidëve, veteranëve dhe pjesëtarëve të UÇK-së dhe familjeve të viktimave civile të luftës.

## **Neni 2**

### **Administrimi me pensione dhe beneficione**

(1) Administrimin me pensionet dhe beneficionet për të drejtat e familjeve të Dëshmorëve, invalidëve, veteranëve dhe pjesëtarëve të UÇK-së dhe familjeve të viktimave civile të luftës, në bazë të kompetencave të përcaktuara me ligj dhe akte tjera nënligjore e bën Departamenti për Familjet e Dëshmorëve, invalidët e luftës dhe viktimat civile ( DFDIL) .

(2) DFDIL-ja përmes Drejtorisë Qendrore dhe zyrave rajonale e bën administrimin e procedurave të aplikimit për pensionet dhe beneficionet për statusin dhe të drejtat e familjeve të dëshmorëve, invalidëve, veteranëve dhe pjesëtarëve të UÇK-së dhe familjeve të viktimave civile të luftës.

## **Neni 3**

### **Dhënia e informatave parashtruesve të kërkesave**

(1) Zyrtarët e DFDIL-së në Drejtorinë Qendrore dhe në zyrat rajonale, do të ofrojnë ndihmë dhe informata parashtruesve të kërkesave për pensionet për statusin dhe të drejtat e familjeve të dëshmorëve, invalidëve, veteranëve dhe pjesëtarëve të UÇK-së dhe familjeve të viktimave civile të luftës.

(2) Zyrtarët e DFDIL-së obligohen ti këshillojnë parashtruesit e kërkesave me rastin e aplikimit, se cilat dokumente duhet ti sjellin për realizimin e të drejtave dhe beneficioneve.

(3) Nëse parashtruesi i kërkesës nuk i posedon dokumentet relevante, zyrtari i DFDIL-së ka për obligim që ta udhëzojë se në cilin organ mund të sigurohen ato dokumente.

## **Neni 4**

### **Plotësimi i kërkesave**

(1) Kërkesa për pension duhet të nënshkruhet nga parashtruesi i kërkesës ose i autorizuari i tij.

(2) Kur parashtruesi nuk është i aftë të nënshkruajë kërkesën dhe nuk ka të autorizuar, atëherë bëhet përjashtim nga paragrafi 4.1 dhe zyrtari i DFDIL-së e vë emrin dhe mbiemrin e aplikuesit në vendin e nënshkrimit të tij.

## **Neni 5** Pranimi i kërkesave

(1) Zyrtari i DFDIL-së duhet të kontrollojë me shumë kujdes, çdo dokument që i bashkëngjitet kërkesës që pranohet.

(2) Parashtruesi i kërkesës mund të paraqesë kërkesë vetëm në njërën prej zyrave rajonale të DFDIL-së.

(3) Nga zyrtari i DFDIL-së kontrollohet vlefshmëria e dokumentacionit dhe saktësia e shënimeve të prezantuara në kërkesë.

(4) Zyrtari i DFDIL-së siguron se kërkesa është plotësuar tërësisht, dhe se parashtruesi i kërkesës ka paraqitur dokumentacione relevante.

(5) Zyrtari i DFDIL-së i ngarkuar për pranimin e kërkesave, përgjigjet për mos kompletimin e dokumentacionit të tërësishëm në përputhje me nenin 6 të këtij Udhëzimi Administrativ.

## **Neni 6** Dokumentacioni që duhet ti bashkëngjitet aplikacionit

Varësisht nga statusi dhe llojet e pensioneve të përcaktuara me ligj, aplikuesit duhet të kenë dokumentacionin përkatës si vijon:

(1) Për realizimin e pensionit familjar dhe beneficioneve tjera të parapara me këtë Ligj, Familja e Dëshmorit duhet të paraqesë këto dokumente:

1. Dokumentin e identifikimit (letërnjoftimi),
2. Vërtetimin e lëshuar nga Shtabi i Përgjithshëm i TMK-së se ka qenë ushtar i UÇK-së dhe është vrarë brenda periudhës 30.12.1991 deri më 19.09.1999, ( sipas nevojës, Shtabi i përgjithshëm i TMK-së për leshurjen e vërtetimeve mund të bashkëpunoj më Shoqatat e dalura nga lufta ),
3. Certifikata e lindjes së aplikantit, në origjinal,
4. Certifikata e vdekjes së Dëshmorit,
5. Certifikata e lindjes së fëmijëve,
6. Certifikata e kurorëzimit në rastet kur aplikon bashkëshorti ose bashkëshortja (në mungesë të certifikatës së kurorëzimit, martesa të vërtetohet në procedurë administrative apo gjyqësore),

7. Kur aplikues janë fëmijët që se kanë asnjërin prind dhe janë nën moshën 18 vjeçare, kërkohet vendim nga Qendra për Punë Sociale për vënien nën kujdestari,
8. Një fotografi të aplikantit.

**(2)** Për realizimin e pensionit familjar dhe beneficioneve të Viktimave Civile, parashtruesi i kërkesës duhet të paraqesë këto dokumente:

1. Dokumentin e identifikimit (letërnjoftimi),
2. Vërtetimin e lëshuar nga organi kompetent komunal se është vrarë në periudhën prej 27.02.1998 deri me 20.06.1999,
3. Certifikata e lindjes së aplikantit, në origjinal,
4. Certifikata e vdekjes së të rënit në luftë,
5. Certifikata e lindjes së fëmijëve,
6. Certifikata e kurorëzimit në rastet kur aplikon bashkëshorti ose bashkëshortja (në mungesë të certifikatës së kurorëzimit, martesa të vërtetohet në procedurë administrative apo gjyqësore),
7. Kur aplikues janë fëmijët që se kanë asnjërin prind dhe janë nën moshën 18 vjeçare, kërkohet vendim nga Qendra për Punë Sociale për vënien nën kujdestari;
8. Një fotografi të aplikantit.

**(3)** Për realizimin e pensionit familjar për të Zhdukurit e Luftës së UÇK-së, parashtruesi i kërkesës duhet të paraqesë këto dokumente:

1. Dokumentin e Identifikimit (letërnjoftimin),
2. Vërtetimin e lëshuar nga Shtabi i Përgjithshëm i TMK-së, se ka qenë ushtar i UÇK-së dhe është zhdukur brenda periudhës 30.12.1991 deri më 19.09.1999, ( sipas nevojës, Shtabi i Përgjithshëm i TMK-së për leshurjen e vërtetimeve mund të bashkëpunoj më Shoqatat e daluara nga lufta),
3. Certifikata e lindjes së aplikantit, në origjinal,
4. Certifikata e kurorëzimit në rastet kur aplikon bashkëshorti ose bashkëshortja (në mungesë të certifikatës së kurorëzimit, martesa të vërtetohet me procedurë administrative apo gjyqësore),
5. Kur aplikues janë fëmijët që se kanë asnjërin prind dhe janë nën moshën 18 vjeçare, kërkohet vendim nga Qendra për Punë Sociale për vënien nën kujdestari,
6. Certifikata e lindjes së fëmijëve,
7. Një fotografi të aplikantit.

**(4)** Për realizimin e pensionit familjar për të Zhdukurit Civil të Luftës parashtruesi i kërkesës duhet të paraqesë këto dokumente:

1. Dokumentin e Identifikimit (letërnjoftimi),
2. Vërtetimin e lëshuar nga organi kompetent komunal se është zhdukur në periudhën prej 27.02.1998 deri me 20.06.1999,
3. Certifikata e lindjes së aplikantit, në origjinal,
4. Certifikata e kurorëzimit në rastet kur aplikon bashkëshorti ose bashkëshortja (në mungesë të certifikatës së kurorëzimit, martesa të vërtetohet me procedurë administrative apo gjyqësore),
5. Kur aplikues janë fëmijët që se kanë asnjërin prind dhe janë nën moshën 18 vjeçare, kërkohet vendim nga Qendra për Punë Sociale për vënien nën kujdestari,

6. Certifikata e lindjes së fëmijëve,
7. Një fotografi të aplikantit.

(5) Për realizimin e pensionit invalidor personal dhe beneficioneve tjera të Invalidit të UÇK-së parashtruesi i kërkesës duhet të paraqesë këto dokumente:

1. Dokumentin e identifikimit (letërnjoftimi),
2. Vërtetimi i lëshuar nga TMK-ja që ka qenë ushtar i UÇK-së dhe se është plagosur në periudhën prej 30.12.1991 deri më 19.09.1999,( sipas nevojës Shtabi i Përgjithshëm i TMK-së për lëshurjen e vërtetimeve mund të baskepunoj më Shoqatat e daluara nga lufta ),
3. Certifikata e lindjes së aplikantit, në origjinal,
4. Certifikatat e lindjes së bashkëshortit/es dhe fëmijëve të Invalidit të UÇK-së,
5. Fletëlëshimin nga spitali ushtarak ku është mjekuar i plagosuri, si dhe dokumentacioni përcjellës mjekësor,
6. Një fotografi të aplikantit,
7. Në rastet kur invalidit të UÇK-së i caktohet shkalla e invaliditetit mbi 80% dhe i nevojitet përkujdesja dhe ndihma e personit tjetër, për këtë person (kujdestarin) nevojitet ky dokumentacion:
  - 1.1 Dokumenti i identifikimit (letërnjoftimi),
  - 1.2 Certifikata e lindjes, në origjinal,
  - 1.3 Vendimin mbi caktimin e kujdestarisë nga Qendra për Punë Sociale,
  - 1.4 Një fotografi të kujdestarit.

(6) Për realizimin e pensionit invalidor personal dhe beneficioneve tjera të Invalidit Civil, parashtruesi i kërkesës duhet të paraqesë këto dokumente:

1. Vërtetimin e lëshuar nga organi kompetent komunal se është plagosur në periudhën 27.02.1998 deri me 20.06.1999,
2. Dokumentin e identifikimit (letërnjoftimi),
3. Certifikata e lindjes së aplikantit, në origjinal,
4. Certifikatat e lindjes së bashkëshortes/it dhe fëmijëve të invalidit civil,
5. Fletëlëshimin e spitalit apo dëshmi nga mjeku i cili e ka mjekuar të plagosurin gjatë kohës së luftës, si dhe dokumentacion përcjellës mjekësor,
6. Një fotografi të aplikantit,
7. Në rastet kur invalidit të UÇK-së i caktohet shkalla e invaliditetit mbi 80% dhe i nevojitet përkujdesja dhe ndihma e personit tjetër, për këtë person (kujdestarin) nevojitet ky dokumentacion:
  - 1.1 Dokumenti i identifikimit (letërnjoftimi),
  - 1.2 Certifikata e lindjes, në origjinal,
  - 1.3 Vendimin mbi caktimin e kujdestarisë nga Qendra për Punë Sociale,

#### 1.4 Një fotografi të kujdestarit.

(7) Për realizimin e pensionit invalidor familjar dhe beneficioneve tjera familja e Invalidit të UÇK-së pas vdekjes së tij, duhet të paraqesë këto dokumente:

1. Dokumentin e identifikimit të aplikantit, (letërnjoftimi),
2. Vërtetimin e lëshuar nga TMK-ja se ka qenë ushtar i UÇK-së dhe është plagosur në periudhën 30.12.1991 deri 19.09.1999,( sipas nevojës, Shtabi i Përgjithshëm i TMK-së për leshurjen e vërtetimeve mund të bashkëpunoj më Shoqatat e daluara nga lufta),
3. Certifikata e lindjes së aplikantit, në origjinal,
4. Certifikata e kurorëzimit në rastet kur aplikon bashkëshorti ose bashkëshortja (në mungesë të certifikatës së kurorëzimit, martesë të vërtetohet me procedurë administrative apo gjyqësore),
5. Kur aplikues janë fëmijët që se kanë asnjërin prind dhe janë nën moshën 18 vjeçare, kërkohet vendim nga Qendra për Punë Sociale mbi vënien nën kujdestari,
6. Certifikata e lindjes së fëmijëve,
7. Certifikata e vdekjes së invalidit të UÇK-së,
8. Një fotografi të aplikantit.

(8) Për realizimin e pensionit invalidor familjar dhe beneficioneve tjera familja e Invalidit Civil pas vdekjes së Invalidit Civil duhet të paraqesë këto dokumente:

1. Dokumentin e identifikimit të aplikantit, (letërnjoftimi),
2. Vërtetimin e lëshuar nga organi kompetent komunal se është plagosur në periudhën 27.02.1998 deri 20.06.1999,
3. Certifikata e lindjes, në origjinal,
4. Certifikata e kurorëzimit në rastet kur aplikon bashkëshorti ose bashkëshortja (në mungesë të certifikatës së kurorëzimit, martesë të vërtetohet me procedurë administrative apo gjyqësore),
5. Kur aplikues janë fëmijët që se kanë asnjërin prind dhe janë nën moshën 18 vjeçare, kërkohet vendim nga Qendra për Punë Sociale mbi vënien nën kujdestari,
6. Certifikata e lindjes së fëmijëve,
7. Certifikata e vdekjes së Invalidit civil,
8. Një fotografi të aplikantit.

(9) Për realizimin e pensioneve të përcaktuara me ligj Familja e Dëshmorit të Kombit duhet të paraqesë këto dokumente:

1. Dokumentin e identifikimit të aplikantit (letërnjoftimi),
2. Vërtetimin e lëshuar nga organi kompetent komunal se ka vepruar për çështje kombëtare individualisht ose i organizuar në grup, i cili është vrarë në formë të ndryshme apo ka rënë në luftë kundër okupatorit në të gjitha periudhat e luftës për liri (data e rënies),
  - a. Dëshmitë e ndryshme në formë të shkruar nga familja, për rënien e Dëshmorit.
3. Certifikata e lindjes, në origjinal,
4. Certifikatat e lindjes së fëmijëve të Dëshmorit,

5. Certifikata e vdekjes së Dëshmorit,
6. Certifikata e kurorëzimit në rastet kur aplikon bashkëshorti ose bashkëshortja (në mungesë të certifikatës së kurorëzimit, martesë të vërtetohet me procedurë administrative apo gjyqësore),
7. Certifikata e lindjes së fëmijëve dhe
8. Një fotografi të aplikantit.

**(10)** Për realizimin e beneficioneve të përcaktuara me ligj Veteranët dhe pjesëtarët e UÇK-sëduhet të paraqesin këto dokumente:

1. Vërtetimin e lëshuar nga TMK-ja se ka qenë veteran dhe pjesëtar i UÇK-së nga 30.12.1991 deri me 19.09.1999,( sipas nevojës Shtabi i Përgjithshëm i TMK-së pr leshurjen e vërtetimeve mund të bashkëpunoj më Shoqatat e daluara nga lufta ),
2. Dokumenti i identifikimit (letërnjoftimi),
3. Certifikata e lindjes së aplikantit, në origjinal,
4. Një fotografi të aplikantit.

## **Neni 7**

**(1)** Nëse kërkesës nuk i bashkëngjitet dokumentacioni nga neni 6, atëherë kërkesa nuk do të pranohet dhe duhet t'i kthehet parashtruesit. Zyrtari i DFDIL-së duhet t'i tregojë arsyet e mospranimit të kërkesës.

**(2)** Nëse fletëaplikacioni është në rregull, zyrtari i DFDIL-së duhet t'ia dorëzojë dëftesën e pranimit parashtruesit të kërkesës, duke e vulosur dhe nënshkruar atë.

**(3)** Dokumentet identifikuese dhe dëshmitë mjekësore origjinale, futen brenda në dosje së bashku me kërkesën dhe nr. e telefonit (i domosdoshëm) për arsye të efikasitetit të procedurës.

**(4)** Me përmbushjen e pikës 7.3 përfundon faza nismëtare e procedimit të kërkesës për pensione dhe beneficione të përcaktuara me ligj.

## **Neni 8**

### Vendimet dhe ankesat

**(1)** Pensioni familjar, pensioni personal invalidor, pensioni familjar invalidor, si dhe shtesat për përkujdesje dhe ndihmë personit tjetër, realizohet nga dita e paraqitjes së kërkesës, nëse janë plotësuar kushtet për realizimin e të drejtës.

**(2)** Parashtruesi i kërkesës, i cili nuk është i kënaqur me vendimin e organit të shkallës së parë, ka të drejtë të ankohet në afat prej 15 ditësh në Komisionin për Ankesa si organ i shkallës së dytë.

Ankesa duhet të bëhet me shkrim duke i përfshirë arsyet pse pala konsideron se vendimi është i padrejtë.

(3) Ankesa e parashtruar pas kalimit të afatit ligjor refuzohet.

(4) Pala e pakënaqur me vendimin e shkallës së dytë, mund ta hapë kontestin administrativ në afat prej 30 ditësh në Gjykatën Supreme të Kosovës.

## **Neni 9**

Ky Udhëzim Administrativ, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i MPMS-së ndërsa, do të aplikohet nga momenti kur fillon paraqitja e kërkesave për pensione dhe beneficione të përcaktuara me Ligjin për Statusin dhe të Drejtat e Familjeve të Dëshmorëve, invalidëve, veteranëve dhe pjesëtarëve të UÇK-së dhe familjeve të viktimave civile të luftës.

Ministri i MPMS

---

Ibrahim Selmanaj